

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXI, nr. 6248
E mërkurë, 24 shkurt 2021
çmimi 0.40 €

Ministria e Arsimit bën thirrje që të respektohen masat anti-Covid në shkolla



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

FLET PËR "EPOKËN E RE", DEMUSH SHASHA | FAQE 4-5

QEVERIA E RE TA AVANCOJË AGJENDËN E BRENDSHME DHE DIALOGUN ME SERBINË



Drejtori ekzekutiv i Institutit EPIK, Demush Shasha, ka thënë se qeveria Kurti 2 nuk ka asnjë pengesë që ta avancojë agjendën e brendshme reformuese dhe ta avancojë

dialogun me Serbinë. Në këtë intervistë dhënë gazetës "Epoka e re", ai ka deklaruar se qeveria e re duhet ta sigurojë pajtimin e interesave të qytetarëve dhe pritjet e partnerëve

ndërkombëtarë. Sipas tij, këto dy prioritet mund të vazhdojnë paralelisht. Shasha ka shprehur skepticizëm se në këtë vit mund të ketë lëvizje pozitive për çështjen e liberalizimit të vizave

SERBIA VAZHDON TA PENGOJË HYRJEN E KUFOMAVE NGA MËRGATA PËR NË KOSOVË

Edhe pse Kosova dhe Serbia kanë nënshkruar në Bruksel marrëveshje për lëvizje të lirë të qytetarëve, njëmbëdhjetë vjet pas Serbia ende vazhdon të mos e lejojë lëvizjen transitorë nëpër territorin e saj të kufomave të cilat transportohen nga mërgata për t'u varrosur në atdheun e tyre në Kosovë. Familjarët që humbin të afërmit e tyre



po u shkaktohen shpenzime financiare sa i përket

gjatësisë së rrugës së transportimit dhe vonesave në kohë. Kompanitë transportuese të kufomave duhet të gjejnë rrugë alternative për të hyrë në Kosovë. Ndërkaq në kohën e pandemisë, vështirësitë në këtë drejtim u thelluan edhe më shumë pasi linjat ajrore u pezulluan për një kohë

KOZ-ja: JAVËN E ARDHSHE PRITEN REZULTATET PËRFUNDIMTARE TË ZGJEDHJEVE



OPINION

KADARE ËSHTË HAPËSIRË E KRIJUAR PËR KOSOVËN F. 11

Bedri ISLAMI



AKTUALE



NË KOMITETIN PËR PUNË TË JASHTME TË PE-SË VOTOHET RAPORTI PËR KOSOVËN F. 5

GJINI PREMTON PËRKRAHJE PËR OJQ-të F. 10

HOXHAJ TAKON SHEFIN E BE-së: PDK-JA DO TË JETË OPOZITË KONSTRUKTIVE F. 3

EKONOMI

PAS REAGIMIT TË ALBIN KURTIT, AKP-ja THOTË SE NUK DO TË KETË VALË TË RE TË PRIVATIZIMIT F. 7

GUVERNATORI I BQK-së: QEVERIA E RE TA KETË PRIORITET ZHVILLIMIN EKONOMIK F. 7



SPORT

PRISHTINA KËRKON FITOREN E TRETË RADHAZI NDAJ DRITËS F. 12

RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepçisht-Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princessha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP S.H.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Maqedonia e Veriut kritikon BE-në për mungesë të ndihmës me vaksina

SHKUP, 23 SHKURT - Përfaqësuesit e Maqedonisë së Veriut kanë thënë të martën se Bashkimi Evropian duhet të bëjë më shumë për ta ndihmuar këtë vend që të sigurojë vaksina kundër koronavirusit. Ministri i Jashtëm, Bujar Osmani, i ka thënë agjencisë së lajmeve AFP, gjatë një vizite në Paris, se vendi i tij ka qenë në gjendje të nisë një fushatë modeste vaksinimi falë dhurimit të disa mijëra dozave të vaksinave nga Serbia. Ai ka shprehur keqardhje për

mungesën e ndonjë ndihme të BE-së duke thënë se Brukseli po dërgon "mesazh të gabuar" në Ballkan, duke e lënë atë pa vaksina.

Osmani, po ashtu, tha se Maqedonia e Veriut vitin e kaluar ka porositur dhe paguar 800 000 doza të vaksinave "AstraZeneca" përmes sistemit "Covax" të Organizatës Botërore të Shëndetësisë, si dhe ka porositur 800 000 doza të tjera drejtpërdrejt nga kompania "Pfizer", porse "asgjë nuk ka ardhur ende". "Çdo ditë që i

vonojmë vaksinat, rrezikon më shumë njerëz, sidomos ata të cenueshmit", ka thënë Osmani. Ai ka shtuar se qeveria maqedonase është duke bërë përpjekje të sigurojë vaksina kineze dhe se 200 000 të tilla pritet të arrijnë në ditët në vijim. Nga vendet e Ballkanit Perëndimor, vetëm Kosova nuk ka nisur ende vaksinimin kundër koronavirusit. Vaksinimi edhe në vendet e BE-së është duke shkuar me ritëm të ngadalshëm për shkak të pengesave me furnizime.



Gjermania zgjat kufizimet në kufijtë tokësorë

BERLIN, 23 SHKURT - Gjermania do t'i vazhdojë kufizimet në kufij tokësorë edhe për tetë ditë të tjera. Ka bërë me dije një zëdhënës i Ministrisë së Brendshme gjermane.

Kufizimet që i ndalojnë shumicën dërrmuese të njerëzve të hyjnë nga Republika Çeke dhe rajoni austriak i Tirolit do të mbeten në fuqi deri më 3 mars, konfirmoi zyrtari gjerman. Këto dy rajone, së bashku me Sllovakinë, janë futur në listën e vendeve me shqetësim të lartë qysh më 14 shkurt, për shkak të normës



së lartë të të infektuarve me koronavirus.

Fillimisht ka qenë e paraparë që kufizimet të zgjasin për dhjetë ditë. Nga kufizimet përjashtohen ata që konsiderohen punëtorë kryesorë, përfshirë drejtuesit e kamionëve që sjellin mallra në vend. Komisioni Evropian tha në një letër drejtuar ambasadorit gjerman në Bruksel, Michael Clauss, se masat janë joproporcionale dhe të pajustificueshme. "Ne besojmë se objektivi i ndjekur nga Gjermania, që është mbrojtja e shëndetit

publik gjatë pandemisë, mund të arrihet me masa më pak kufizuese", thuhet në letër.

Republika Çeke ka normën më të lartë të infektimit me koronavirus brenda Bashkimit Evropian. Që nga fillimi i pandemisë në pranverën e vitit të kaluar, ky shtet ka regjistruar mbi 1.16 milion raste me koronavirus dhe më shumë se 19 500 viktima.

Në Gjermani, numri total i të infektuarve ka arritur në mbi 2.3 milionë, ndërsa i viktimitave në mbi 68 000.

Në Katar rinisin bisedimet për paqen afgane

DOHA, 23 SHKURT - Bisedimet për paqe në mes të talibanëve dhe qeverisë afganë janë rikthyer në Katar pas më shumë se një muaji si pasojë e përshkallëzimit të dhunës në shtetin e shkatërruar nga lufta. Kombet e Bashkuara kanë kërkuar sërish armëpushim për ta zvogëluar numrin e viktimitave.

Zëdhënësi i talibanëve, Mohammad Naeem, ka thënë në orët e vona të 22 shkurtit, se bisedimet kanë nisur. Agjencia "Tolo" ka cituar Naeem të ketë thënë se takimi është mbajtur në mes të udhëheqësve të delegacioneve dhe disa pjesëtarëve të ekipeve negociatore në Doha dhe se

aty është diskutuar për vazhdimësi të negociatave. Naeem ka thënë se grupet punuese do t'i vazhdojnë takimet e tyre sipas agjendës. Bisedimet në mes të dyja palëve janë ndërprerë pak pas fillimit muajin e kaluar.

Prioriteti kyç i bisedimeve për Qeverinë afgane dhe Shtetet e Bashkuara është zvogëlimi i shkallës së dhunës që do të rezultonte më pas me armëpushim.

Talibanët kanë thënë se një gjë e tillë është e negociueshme, ndonëse ende nuk kanë arritur tek armëpushimi potencial.

Kombet e Bashkuara kanë publikuar të martën një

raport, në të cilin është thënë se, ndonëse numri i afganëve të vrarë dhe të plagosur ka rënë për 15 për qind vitin e kaluar, në krahasim me vitin 2019, dhuna është rritur në muajt e fundit të 2020-s.

Në raport është thënë se ulja e numrit të viktimitave është rezultat i asaj që duket se është ndryshim i taktikave të vrasjeve.

Mirëpo në raport ka pasur vërejtje alarmuese për numrin në rritje të viktimitave në tre muajt e fundit të vitit 2020 kur kanë nisur bisedimet për paqe.

Numri total i viktimitave vitin e kaluar ka qenë 8 820 - duke përfshirë 3 035 të vrarë 5 785 të



plagosur - shifër që ka rënë nën 10 000 për herë të parë prej vitit 2013.

Gratë afgane dhe fëmijët përbëjnë 43 për qind të të gjitha viktimitave.

Avionët luftarakë të Greqisë provokojnë anijen turke kërkimore në Detin Egje



ATHINË, 23 SHKURT - Avionët luftarakë të Greqisë kanë provokuar anijen turke TCG Çeşme në ujërat ndërkombëtare të Egjeut verior, e cila kryente kërkime shkencore dhe teknike në zonën hidrografike. Një nga katër avionët luftarakë grek ka "provokuar" anijen kërkimore

me fishek "chaff" duke iu afruar në një distancë prej 2 milje detare.

Përderisa Turqia mbron qëndrimin e zgjidhjes së problemeve në Egje dhe Mesdheun Lindor brenda marrëdhënies së të drejtës ndërkombëtare, fqinjësisë së mirë dhe dialogut, Greqia

vazhdon çdo lloj aktiviteti që përshkallëzon tensionet në rajon. Që nga 25 janari kur filluan bisedimet këshillimore, Greqia në veriperëndim të ishullit Skyros, zona që përfshin edhe ujëra ndërkombëtare, zhvilloi stërvitjen "Rrufe-21" me 20 anije dhe shumë mjete ajrore.

KQZ-ja: Javën e ardhshme priten rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve



Zëdhënësi i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Valmir Elezi, në një konferencë për media të martën, ka bërë me dije se rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve të 14 shkurtit mund të shpallen gjatë javës së ardhshme. “Procesi i rinumërimit të vendvotimit po shkon sipas dinamikës që kemi paraparë. Janë 28 tavolina ku po zhvillohet procesi i rinumërimit dhe besojmë se procesi do të përmbyllet deri të premten në mbrëmje. Gjatë fillimit të javës së ardhshme, besoj se KQZ-ja mund të dalë me shpalljen e rezultatit përfundimtar të këtyre zgjedhjeve”, ka thënë Elezi

rinumërimit kanë të bëjnë me: bartje të gabuar të votave në formularin e subjekteve politike (35 vendvotime); bartje të gabuar të votave në formularin e kandidatëve (6 vendvotime); kandidati apo kandidatët kanë më shumë vota se subjekti politik (370 vendvotime); dhe subjekti ka vota, ndërsa kandidatët jo dhe anasjelltas (83 vendvotime)”, ka treguar Elezi.

Ai ka theksuar se në këtë qendër KQZ-ja është duke vijuar procesin e vlerësimit të rreth 43 mijë e 500 pakove të supozuara me fletëvotime që kanë ardhur nga jashtë Kosovës. “Sipas të dhënave më të fundit, janë hapur 25 153 pako të supozuara me fletëvotime, prej nga kemi të aprovuara 29 087 zarfe me

fletëvotime dhe 11 840 zarfe të refuzuara”, është shprehur Elezi. Sipas tij, arsyet e mosaprovimit të disa votave nga jashtë janë të ndryshme. “5 078 zarfe janë dërguar nga persona që nuk janë të regjistruar si votues jashtë Kosovës; 3 836 zarfe janë dërguar nga persona që nuk kanë arritur të regjistrohen si votues jashtë Kosovës gjatë periudhës së aplikimit sepse nuk kanë dëshmuar kriteret ligjore; 908 votues kanë dërguar fletëvotime nga dy herë; 1 551 zarfe të dërguara nga votues të paidentifikuar (votim grupor); 467 zarfe të dërguara nga votues të cilët kanë bashkangjitur dokumente jovalide për identifikim”, ka thënë zëdhënësi i KQZ-së, Valmir Elezi.

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 23 SHKURT - Zëdhënësi i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Valmir Elezi, ka thënë se në fillim të javës së ardhshme ky institucion pritet të dalë me rezultate përfundimtare për subjektet politike dhe kandidatët. “Procesi i

rinumërimit të vendvotimit po shkon sipas dinamikës që kemi paraparë. Janë 28 tavolina ku po zhvillohet procesi i rinumërimit dhe besojmë se procesi do të përmbyllet deri të premten në mbrëmje. Gjatë fillimit të javës së ardhshme besoj se KQZ-ja mund të dalë me shpalljen e rezultatit përfundimtar të këtyre zgjedhjeve”, ka thënë ai.

Elezi ka thënë se në Qendrën e Numërimit dhe të Rezultateve po vazhdon procesi i rinumërimit të vendvotimeve për të cilat ka vendosur Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. “Deri më tani janë rinumëruar 15 për qind apo 76 vendvotime nga 494 sa është numri i përgjithshëm i tyre dhe që u takojnë komunave të ndryshme të Kosovës. Arsyet e

Hoxhaj takon shefin e BE-së: PDK-ja do të jetë opozitë konstruktive

PRISHTINË, 23 SHKURT (ER) - Kryetari i Partisë Demokratike i Kosovës, Enver Hoxhaj, i shoqëruar nga anëtarja e kryesisë, Blerta Deliu Kodra, ka pritur në takim ambasadorin e Bashkimit Evropian në Kosovë, Tomas Szunyog. Gjatë këtij takimi është diskutuar për situatën aktuale politike në Kosovë, për proceset e rëndësishme që e presin vendin në vijim, për zhvillimin e dialogut Kosovë - Serbi dhe për bashkëpunimin rajonal. Hoxhaj ka theksuar nevojën për konstituimin e Kuvendit dhe

formimin e menjëhershëm të qeverisë pas certifikimit të rezultateve sepse, sipas tij, qytetarët kanë nevojë për dorën e shtetit. Ai ka bërë me dije se do të vazhdojë të jetë opozitë konstruktive. “Rezultatet e dala nga zgjedhjet e 14 shkurtit dhe pjekuria politike e partive tregojnë që Kosova ka demokraci të konsoliduar dhe të fortë karshi vendeve të rajonit”, ka thënë Hoxhaj. Ndërkaq, ambasadori i BE-së në Kosovë, Tomas Szunyog, ka inkurajuar PDK-në për të qenë opozitë konstruktive e pushtetit.





FLET PËR "EPOKËN E RE", DEMUSH SHASHA

Qeveria e re ta avancojë agjendën e brendshme dhe dialogun me Serbinë

Drejtori ekzekutiv i Institutit EPIK, Demush Shasha, ka thënë se qeveria Kurti 2 nuk ka asnjë pengesë që ta avancojë agjendën e brendshme reformuese dhe ta avancojë dialogun me Serbinë. Në këtë intervistë dhënë gazetës "Epoka e re", ai ka deklaruar se qeveria e re duhet ta sigurojë pajtimin e interesave të qytetarëve dhe pritjet e partnerëve ndërkombëtarë. Sipas tij, këto dy prioritete mund të vazhdohen paralelisht. Shasha ka shprehur skepticizëm se në këtë vit mund të ketë lëvizje pozitive për çështjen e liberalizimit të vizave

EPOKA E RE**Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 23 SHKURT -

"Epoka e re": Z. Shasha, Kosova ka organizuar zgjedhjet e 14 shkurtit sipas standardeve të kërkuara. Cili mund të jetë ndikimi i këtyre zgjedhjeve në raportet e Kosovës me BE-në?

Shasha: Procesi zgjedhor është vlerësuar lart nga ana e BE-së.

Institucionet e BE-së kanë bërë tani thirrje që të konstituohen të gjitha institucionet e reja dhe të sigurohet stabiliteti politik në Kosovë. Konsideroj se qeveria e re e ka mundësinë e artë të bëjë përparim në marrëdhënien e Kosovës me BE-në, duke siguruar zbatimin e reformave të parapara në agjendën evropiane me qëllim të fitimit të statusit të vendit kandidat.

Kosova dhe Bosnja mbesin të vetmet dy vende në Ballkan të cilat nuk gëzojnë statusin e vendit kandidat.

"Epoka e re": Çfarë duhet të jetë qasja e qeverisë së re ndaj BE-së?

Shasha: Konsideroj se qeveria e re duhet të tregojë përkushtim konkret për avancimin e rrugës integruese të vendit duke bërë

përparim në zbatimin e obligimeve që burojnë nga Marrëveshja Stabilizim Asocimit dhe avancimin e dialogut Kosovë - Serbi. Në këtë drejtim prioritet do të jetë sundimi i ligjit dhe lufta kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, reforma e administratës publike dhe respektimi i parimeve të mirëqeverisjes në të gjitha institucionet e shtetit. Po ashtu, përparimi i ndjeshëm në raportet tona me Serbinë do të ishte hap kyç për avancimin e rrugës integruese të vendit.

"Epoka e re": Fituesi i zgjedhjeve të 14 shkurti, Albin Kurti, ka bërë me dije se qeveria e tij nuk do ta ketë prioritet dialogun me Serbinë, ndërsa

ShBA-ja dhe BE-ja i kanë bërë të qarta qëndrimet e tyre. Si e shihni vazhdimin e këtij procesi?

Shasha: Konsideroj se është e gabueshme ta mendojmë dialogun në terma ekskluzivë. Konsideroj se nuk ka asnjë pengesë që qeveria e ardhshme e Kosovës të bëjë dy gjëra të njëjtën kohë - edhe ta avancojë agjendën e brendshme reformuese në luftë kundër korrupsionit/krijimit e vendeve të reja punës, edhe ta avancojë dialogun me Serbinë. Po filloj nga e para. Për së paku 10 vjetët e fundit institucionet e Kosovës nuk kanë përfaqësuar legjitimitetin e plotë qytetar, por kanë qenë produkt i makinacioneve politike. Si të tilla, agjendat e tyre qeverisëse



ketë mandat plotësisht legjitim i cili do jetë i lidhur drejtpërdrejt me vullnetin e qytetarëve. Në këtë drejtim, z. Kurti nuk ka marrë mandat nga qytetarët për ta kontrabanduar votën e tyre nga një mandat për drejtësi dhe ekonomi për qytetarët e Kosovës në një mandat dialogu me Serbinë. Rrjedhimisht, konsideroj se qeveria Kurti do të veprojë drejt nëse nuk shpenzon gjithë kapitalin e saj politik në dialogun me Serbinë. Dhe kjo, në fakt, është në përputhje të plotë me brengat dhe pritjet e qytetarëve. Sipas studimit të PIPS-it

“Politikat ndërkombëtare dhe dialogu me Serbinë” (dhjetor 2020), 63 për qind të qytetarëve nuk besojnë se një marrëveshje me Serbinë do të ndikojë në përmirësimin e jetës së tyre. Nga ana tjetër, vetëm 14.7 për qind mendojnë që do të ndikojë. Njëkohësisht, 72 për qind konsiderojnë se shtetësia e Kosovës nuk rrezikohet nga mosnjohja e Serbisë. Edhe sondazhet e fundit në prag të zgjedhjeve të 14 shkurtit 2020 treguan që qytetarët e Kosovës nuk e shohin dialogun me Serbinë si çështje prioritare. Në sondazhin e “Grupit Koha”, dialogu me Serbinë zuri vendin e 9 për nga rëndësia. Nga ana tjetër, sondazhi identifikoi se tri top prioritetet për qytetarët janë: krijimi i vendeve të reja punës, shëndetësia dhe lufta kundër korrupsionit. Në këtë frymë Pulsi Publik i UNDP-s për vitin 2020 gjeti se 76 për qind të qytetarëve të Kosovës shohin prioritet luftën kundër korrupsionit dhe krijimin e vendeve të reja të punës. Pra, ajo çfarë është më se e qartë është se për qytetarët e Kosovës krijimi i vendeve të reja punës,

luftimi i korrupsionit dhe krimin të organizuar, shëndetësia dhe arsimit janë prioritetet kryesore - jo dialogu me Serbinë. Duhet thënë, po ashtu, për hir të korrektësisë, se ka edhe një vështirësi në leximin e këtyre sondazheve. “Dialogu me Serbinë” ka fituar një konotacion negativ në shoqërinë e Kosovës. Perceptohet me automatizëm si një gjë negative. Dhe për këtë përgjegjësinë e kanë partitë politike të cilat që nga fillimi i dialogut kanë përdorur atë si mjet për zgjatjen e pushtetit. Nga ana tjetër, po ashtu duhet njohur faktin që është në interesin e Kosovës që t’i zgjidhë të gjitha çështjet e hapura me një fqinj të saj me të cilin do të jetojë në paqe në një hapësirë të bashkuar evropiane dhe ta sigurojë konsolidimin e plotë në skenën ndërkombëtare. Ky është, po ashtu, interesi dhe angazhimi i partnerëve tanë kyç ndërkombëtarë. Në këtë drejtim, në reagimet e para ShBA-ja dhe BE-ja kanë bërë të qartë se dialogu është një nga pritjet kryesore të tyre nga qeveria e re. Në këtë kontekst, qeveria Kurti 2 duhet ta sigurojë pajtimin e këtyre dy realiteteve: interesat e qytetarëve dhe pritjet e partnerëve ndërkombëtarë. Dhe këtu unë them se nuk shoh asnjë pengesë që qeveria ta fokusojë energjinë e saj në këto dy drejtime paralelisht ose pothuaj paralelisht.

E them “pothuaj paralelisht” sepse një aspekt i rëndësishëm i diskutimit mbi avancimin e dialogut është: koha. Dhe në këtë drejtim është shumë me rëndësi ta rikujtojmë edhe deklaratën e presidentit Vuçiq i cili përjashtoi çfarëdo mundësie

që të ketë marrëveshje me Kosovën deri në prill 2022 kur do të mbahen zgjedhjet parlamentare dhe presidenciale të Serbisë. Kjo krijon një hapësirë kohore ku qeveria Kurti 2 mund ta fokusojë vëmendjen e saj gjatë vitit 2021/2022 në çështje të brendshme, duke zhvendosur vëmendjen më pastaj në vitin 2022/2023 në dialogun me Serbinë. Dhe në këtë drejtim konsideroj se debati publik nuk duhet të jetë se a mbështet një qeveri apo jo dialogun, kjo pasi që besoj se të gjitha qeveritë eventualisht do ta mbështesin dialogun. Çështja besoj duhet shtruar në dy rrafshë më konkrete: (1) Cili është kompromisi për ta fituar anëtarësimin në OKB? dhe (2) Kur duhet bërë ky kompromis? Dhe përgjigja në këto pyetje asnjëherë nuk duhet të jetë e një mazhorance, por rezultat i një konsensusi shoqëror që do të arrihet me anë të një procesi konsultativ dhe të parashikueshëm publik.

“Epoka e re”: Cilat janë pritjet e juaja për këtë proces? A mund të kushtëzohet avancimi i Kosovës në rrugën e saj evropiane me dialogun me Serbinë?

Shasha: Unë nuk pres përparim të ndjeshëm në dialogun Kosovë - Serbi në një afat të shkurtër kohor. Në afat të mesëm konsideroj se të dyja palët, nën fasilitimin e BE-së dhe mbështetjen e ShBA-së, duhet të angazhohen në negociata thelbësore diplomatike. Një qasje e tillë do të kërkonte që përmes një pune intensive diplomatike të identifikohen disa skenarë të mundshëm që do të mund të ishin pjesë

thelbësore e marrëveshjes së ardhshme Kosovë - Serbi. Vetëm pas arritjes së një pajtimi parimor se çfarë do të mund të ishte thelbi i marrëveshjes së ardhshme Kosovë - Serbi, liderët e dy vendeve do të mund fillonin një diskutim gjithëpërfshirës shoqëror për rëndësinë e marrëveshjes në mes dy vendeve dhe arritjen e konsensusit për kompromiset në të dyja anët e kufirit. Sidoqoftë, një qasje e këtillë thjesht kërkon kohë, transparencë dhe dialog, prandaj rrjedhimisht nuk kam pritjet ambicioze për arritjen e një marrëveshje gjithëpërfshirëse në një afat të shkurtër kohor.

“Epoka e re”: Prej vitësh Kosova është duke e pritur liberalizimin e vizave nga BE-ja. Pas formimit të institucioneve të reja, mund të ndodhë diçka në këtë vit?

Shasha: Jam tejet skeptik se do të ketë lëvizje pozitive sa i përket kësaj çështje gjatë këtij viti për dy arsye: (1) pandemia ka krijuar një mjedis politik ku momentalisht Gjermania është duke rivendosur kufirin me Çekinë dhe Austrinë. Prandaj të mendosh se në këtë kontekst do të hiqen kufijtë ndaj vendeve të treta është e paimagjinueshme; (2) disa vende anëtare të BE-së vazhdojnë të mendojnë se Kosova nuk ka përmbushur kriteret për liberalizimin e vizave, respektivisht në luftë kundër korrupsionit të nivelit të lartë dhe krimin të organizuar. Që nga vendosja e këtij kriteri para pesë vjetësh Kosova ende ka zero raste të suksesshme në luftë kundër korrupsionit të nivelit të lartë.

nuk ka qenë të përcaktuara nga vullneti i qytetarëve, por nga interesat partiake. Në këtë kontekst, qeveria Kurti 2 do jetë për herë të parë nga shpallja e pavarësisë qeveri e cila do të

Në Komitetin për Punë të Jashtme të Parlamentit Evropian votohet raporti për Kosovën

PRISHTINË, 23 SHKURT - Eurodeputeti austriak Lukas Mandl ka bërë me dije se të martën kanë votuar raportin për Kosovën në Komitetin për Punë të Jashtme në Parlamentin Evropian. Mandl në një postim në “Twitter” ka shkruar se me këtë raport kanë dhënë mesazhe të forta mbi liberalizimin e vizave, njohjen, dialogun Kosovë - Serbi etj. “Sot ne votuam në Komitetin për Punë të Jashtme në Parlamentin Evropian, Raportin për Kosovën, që unë e kam negociuar në emër të Grupit EEP. Ne kemi dhënë mesazhe të forta mbi liberalizimin e vizave, njohjen, dialogun Kosovë - Serbi dhe perspektivat për të rinjtë për digjitalizimin dhe fusha të tjera”, ka shkruar Mandl në “Twitter”.



Rashiqi: Sulmi ndaj djalit tim ishte i paralajmëruar

PRISHTINË, 23 SHKURT - "Grupi i personave që e ka pritur djalim tim pas shkollës, një ditë më herët ka publikuar në 'Facebook' dhe 'Instagram' postime ku thuhet 'nesër prehet shiptari' dhe 'kush do ta mbijetojë të hënën do të tregojë për të'", ka thënë për "Radion Evropa e Lirë", Nenad Rashiq, lider i Partisë Demokratike Progresive. Ai më pas, në një konferencë për media në "Qendrën Mediale" në Çagllavicë, i bëri publike këto postime.

Djali i Rashiqit, Nikolla (18 vjeç), është sulmuar të hënën, më 22 shkurt, në Llapnasellë të Graçanicës, komunë e banuar me shumicë serbe. "I janë afruar djalit tim dhe i kanë thënë 'çka bën tash, ti shiptar', ka treguar Rashiq. "Shiptar"

është term pezorativ që përdoret në gjuhën serbe ndaj shqiptarëve. Nikollës i është thyer nofulla dhe tre dhëmbë. "Djali im ishte caku. Sipas mendimit tim, kjo ishte tentimvrasje", ka thënë Rashiq, duke theksuar se sulmi ndaj djalit të tij ishte i paralajmëruar.

Ai mendon se e gjithë kjo është "pasojë e kundërshtimit të tij shumëvjeçar ndaj presioneve politike". Policia e Kosovës në një përgjigje me shkrim për "REL", ka konfirmuar se në këtë "rrahje masive kanë marrë pjesë nxënës të shkollës së mesme, por edhe disa persona të tjerë" dhe se një person ka marrë lëndime të rënda trupore dhe më pas është dërguar në spital. Për këtë rast, Policia ka ndaluar tetë persona, në mesin



e të cilëve edhe një person të mitur. Ndaj tetë personave është caktuar masa e ndalimit prej 48 orësh, për shkak se ata dyshohen se kanë marrë pjesë

në rrahje. Nga Prokuroria Themelore në Prishtinë kanë thanë se Prokurori i Shtetit do të bëjë kërkesë për masën e paraburgimit ndaj të

ndaluarve.

Lidhur me këtë incident kanë reaguar përfaqësues të institucioneve në Kosovë dhe ambasadorë të huaj.

Ministria e Arsimit bën thirrje që të respektohen masat anti-Covid në shkolla



Ministria e Arsimit dhe Shkencës (MASH) ka bërë thirrje që shkollat të vazhdojnë t'i respektojnë masat kundër pandemisë Covid-19 në mënyrë që mësimi të vazhdojë të zhvillohet sipas skenarit A, me prani në shkollë. Katër viktima dhe 368 raste të reja me Covid janë konfirmuar të martën në Kosovë

EPOKA E FATON DËRMAKU

PRISHTINË, 23 SHKURT - Ministria e Arsimit dhe Shkencës (MASH) u ka bërë thirrje të gjithë aktorëve të përfshirë në sistemin arsimor që të vazhdojnë t'i respektojnë masat kundër pandemisë Covid-19 në mënyrë që mësimi të vazhdojë të zhvillohet sipas skenarit A, pra me prani në shkollë.

Mësimdhënësit, nxënësit, prindërit dhe menaxhmenti i shkollave duhet të kenë kujdes të vazhdueshëm në respektimin e distancës, higjienës dhe bartjes së maskës. Po ashtu, MASH-i kërkon nga studentët, mësimdhënësit, menaxhmentet e universiteteve dhe fakulteteve, si dhe kolegjeve për respektimin strikt të masave parandaluese ndaj pandemisë. MASH-i, po ashtu, kërkon nga institucionet

e arsimit në të gjitha nivelet që të ndërmarrin masa parandaluese dhe mbrojtëse sipas rekomandimeve të IKShPK-së dhe MSh-së.

Katër viktima dhe 368 raste të reja me Covid në Kosovë

Gjatë 24 orëve të fundit në Laboratorin e Mikrobiologjisë

Molekulare në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK) dhe laboratorët privatë janë testuar gjithsej 2 843 mostra të marra nga ShSKUK-ja dhe gjurmimi i kontakteve të rasteve në terren, prej të cilave kanë rezultuar 368 raste pozitive me Covid. Brenda 24 orëve janë raportuar katër raste të të vdekurve si pasojë e këtij virusi. Rastet e të

vdekurve janë nga komunat: Prishtinë dy raste (71, 86 vjeç), Prizren një rast (78 vjeç) dhe Shtime një rast (62 vjeç).

Numri total i rasteve pozitive është 67 008 raste nga 291 847 persona të dyshimtë me këtë virus dhe 1 579 raste të vdekjes.

Gjatë 24 orëve të fundit janë shëruar 241 pacientë derisa numri i përgjithshëm i të shëruarve deri më sot është gjithsej 58 600 raste, kurse numri i rasteve aktive është 6 829. Rastet pozitive janë nga komunat: Prishtinë 211 raste, Gjilan 30 raste, Fushë-Kosovë 25 raste, Lipjan 15 raste, Ferizaj 14 raste, Pejë 12 raste, Obiliq 10 raste, Podujevë 9 raste, Gjakovë 5 raste, Graçanicë 5 raste, Suharekë 5 raste, Mitrovicë 4 raste, Shtime 4 raste, Vushtrri 4 raste, Kamenicë 3 raste, Viti 3 raste, Prizren 2 raste, Skenderaj 2 raste dhe me nga një rast komunat Deçan, Drenas, Istog, Kaçanik dhe Shtërpçë.

Në takimin e Komitetit për Menaxhimin e Pandemisë, që u mbajt të hënën, ministri në detyrë i Shëndetësisë, Armend Zemaj, ka bërë me dije se situata me Covid-19 është në kontroll dhe ka bërë thirrje që të vazhdohet respektimi i masave në fuqi. Ai ka thënë se në mënyrë rigorozë të respektohen masat mbrojtëse nga të gjitha institucionet publike dhe private: Distanca fizike, përdorimi i maskave, dezinfektimi dhe ajrosja e lokaleve.

Pas reagimit të Albin Kurtit, AKP-ja thotë se nuk do të ketë valë të re të privatizimit

EPOKA
ERE

Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 23 SHKURT - Kryetari i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, nëpërmjet një reagimi publik ka thënë se Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) po planifikon të realizojë një valë të re të privatizimit, sipas tij, në kundërshtim me vendimet e institucioneve të vendit. Por, ndaj kësaj ka reaguar ky institucion. Siç ka njoftuar AKP-ja, një valë e re e privatizimit nuk do të ndodhë derisa të formohen institucionet e reja në vend. "Bordi i Drejtorëve i Agjencisë Kosovare të Privatizimit njofton opinionin se në takimin e tij joformal të mbajtur javën e kaluar, më datë 19 shkurt 2021, ka udhëzuar menaxhmentin e AKP-së që të mos vazhdojë valën e shitjes deri në krijimin e institucioneve të dala nga

zgjedhjet e datës 14 shkurt 2021", thuhet në njoftimin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit.

AKP-ja, gjithashtu, ka bërë të qartë se ka qenë bashkëpunuese dhe vazhdimisht ka ofruar mbështetjen në vazhden e përpjekjeve të secilës qeveri për ta ndryshuar strategjinë e privatizimit të ndërmarrjeve dhe pronave shoqërore. "AKP-ja ka ofruar bashkëpunim të shkëlqyeshëm me Komisionin Hetimor Parlamentar, duke iu përgjigjur të gjitha kërkesave dhe duke shpalosur të gjithë dokumentacionin e kërkuar", thuhet më tutje në njoftimin e këtij institucioni.

Më tej, AKP-ja thotë që të ketë kujdes rreth deklarimeve publike nga aktorët publikë në Kosovë. "Andaj, për shkak të ndjeshmërisë së procesit, të gjithë aktorëve politikë e



institucionalë u bëjmë thirrje që të jenë të kujdesshëm dhe të përmbahen nga kualifikimet publike të bazuara në informata jo të plota, të cilat për më tepër janë paragjyqese dhe të dëmshme për imazhin e një institucioni të pavarur

kushtetues dhe ligjor, si dhe integritetin personal dhe profesional të zyrtarëve brenda këtij institucioni", thuhet në reagimin e AKP-së.

Lideri i Lëvizjes Vetëvendosje dhe kandidati për kryeministër nga kjo lëvizje, Albin Kurti, ka

bërë me dije se është informuar se bordi i AKP-së "krejtësisht paligjshëm po synon keqpërdorimin e vakuumit institucional duke tentuar të fillojë valë të reja të likuidimit në kundërshtim me vendimet e lartpërmendura". "Thirrjet e bordit në gjoja pavarësinë e institucionit dhe në nevojën që paska vendi për privatizim më të shpejtë në mënyrë që të gjenerohen të hyra shtesë për buxhetin e shtetit, janë konfirmim i mëtejshëm i brengës sonë për keqpërdorime në këtë institucion. E shoh shumë të rëndësishme që publikisht t'i drejtohem bordit të AKP-së me kërkesë që të mos sfidojë mekanizmat institucionalë dhe të mos provojë të hapë valë të reja të privatizimit apo likuidimit në kundërshtim me vendimet që janë në fuqi", ka shkruar Kurti në llogarinë e vet në "Facebook".

Guvernatori i BQK-së: Qeveria e re ta ketë prioritet zhvillimin ekonomik



PRISHTINË, 23 SHKURT - Guvernatori i Bankës Qendrore të Kosovës (BQK), Fehmi Mehmeti, ka thënë se sektori bankar ka pasur dhe

vazhdon ta ketë rolin e saj në rimëkëmbjen ekonomike të Kosovës. "Sektori bankar është mirë i kapitalizuar dhe likuid. Ky sektor e ka

ndihmuar shumë ekonominë edhe gjatë kohës së pandemisë. Bankat kanë dhënë kredi mbi 1.5 miliard euro gjatë pandemisë, kemi

rënie të normave të interesit bankar dhe kjo ka ndihmuar shumë. Ky sektor ka kapacitet të luajë rol kyç për rimëkëmbje ekonomike pas


pandemisë", ka thënë ai në "RTK". Ai ka deklaruar se qeveria e ardhshme duhet të ketë fokus zhvillimin ekonomik.

Oda e Hotelierisë: Nuk do t'i respektojmë masat e reja anti-Covid

PRISHTINË, 23 SHKURT (ER) - Oda e Hotelierisë dhe Turizmit të Kosovës ka reaguar ndaj paralajmërimit për vendosjen e masave të reja mbrojtëse ndaj Covid-19. "Oda e Hotelierisë dhe Turizmit të Kosovës edhe një herë bën thirrje që kushdo që është duke planifikuar masa të reja: Mos i kufizoni

bizneset më dhe mos bëni eksperimente, përndryshe asnjë masë e palogjikshme nuk do të merret parasysh dhe nuk do të respektohet!", është thënë në reagimin e kësaj ode, kryetar i së cilës është Hysen Sogojeva. Ky i fundit u ka bërë thirrje të gjitha bizneseve nga të gjitha sektorët që të vazhdojnë t'i

respektojnë masat e manualit për të cilat kanë punuar së bashku. "Bizneset në fushën e gastronomisë dhe hotelierisë edhe gjatë kohës së fushatës zgjedhore kanë respektuar masat e manualit, kurse partitë politike dhe udhëheqësit e tyre nuk i kanë respektuar", ka thënë Sogojeva.





Serbia vazhdon ta pengojë hyrjen e kufomave nga mërgata për në Kosovë

Edhe pse Kosova dhe Serbia kanë nënshkruar në Bruksel marrëveshje për lëvizje të lirë të qytetarëve, njëmbëdhjetë vjet pas Serbia ende vazhdon të mos e lejojë lëvizjen transitorë nëpër territorin e saj të kufomave të cilat transportohen nga mërgata për t'u varrosur në atdheun e tyre në Kosovë. Familjarët që humbin të afërmit e tyre po u shkaktohen shpenzime financiare sa i përket gjatësisë së rrugës së transportimit dhe vonësive në kohë. Kompanitë transportuese të kufomave duhet të gjejnë rrugë alternative për të hyrë në Kosovë. Ndërkaq në kohën e pandemisë, vështirësitë në këtë drejtim u thelluan edhe më shumë pasi linjat ajrore u pezulluan për një kohë

EPOKA ERE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 23 SHKURT - Pronarët e kompanive "Pikëllimi" dhe "Funerali-Elezi" që merren me transportimin e kufomave nga mërgata për në Kosovë thonë se atyre nuk u lejohet transportimi i kufomave nga mërgata nëpër territorin e Serbisë. Këtë ata e kanë cilësuar mjaft sfiduese si në aspektin financiar për shkak se detyrohen të bëjnë qindra kilometra duke gjetur rrugë alternative, por edhe për shkak të aspektit kohor. Ata kanë thënë se për këtë problem prej vitesh kanë kërkuar ndihmë

nga institucionet e Kosovës, mirëpo deri më tani kjo ka mbetur vetëm në nivel premtimesh. Të njëjtët kanë apeluar që kjo çështje sa më shpejt të diskutohet në bisedime me Serbinë në kuadër të dialogut në Bruksel. Në marrëveshjen e arritur më 2 korrik në vitin 2011 në Bruksel në mes të Kosovës dhe Serbisë është e specifikuar lëvizja e lirë. Në pikën 1 të kësaj marrëveshje thuhet: "Qytetarët (me vendbanim të përkohshëm) të të dyjave palëve duhet të kenë mundësi të udhëtojnë lirshëm brenda ose përmes territorit të njëra-tjetrës". Ndërkaq në pikën 2 thuhet: "Secila palë do

KONKLUZAT E DAKORDUARA 2 KORRIK 2011	
Liria e lëvizjes	
1.	Qytetarët (me vendbanim të përhershëm) të të dyjave palëve duhet të kenë mundësi të udhëtojnë lirshëm brenda ose përmes territorit të njëra-tjetrës.
2.	Secila palë do të zbatojë, sa më shpejt që është e zbatueshme në aspekt operativ, një sistem të kalimit të kufirit/kufirit administrativ të qytetarëve të palës tjetër me letërnjoftime;
3.	Secila palë mund të zbatojë një sistem ku letërnjoftimet do të shoqërohen nga dokumente me shkrim "hyrje-dalje" për personat nga pala tjetër të cilët dëshirojnë të kalojnë tranzit në një shtet të tretë.
4.	Si zgjidhje kalimtare, secila palë do t'ua mundësojë qytetarëve të palës tjetër blerjen e polisave të sigurimit kufitar/kufitar administrativ. Nën përkujdesjen e BE, palët do të vazhdojnë të punojnë për një marrëveshje komerciale për sigurimin reciprok të automjeteve ashtu që të gjitha automjetet në të dy anët e kufirit/kufirit administrativ të jenë të siguruara sa më shpejt që është e mundur.
5.	Secila palë do të marrë të gjitha masat që t'ua mundësojë qytetarëve të palës tjetër të udhëtojnë lirshëm brenda dhe përmes territorit të njëra-tjetrës me patentshoferin e lëshuar nga autoritetet e veta.
6.	Si masë kalimtare, autoritetet në Kosovë do të vazhdojnë vlefshmërinë e targave KS të automjeteve për një periudhë fillestare prej pesë vitesh në përfundim të së cilës çështja do të rishikohet nga të dyja palët (me lehtësimin e BE nëse kërkohet);
7.	Të gjithë pronarët e automjeteve me vendbanim në Kosovë do të përdorin targat RKS ose KS (sipas pikës 6 më lartë). Ato do të lëshohen nga autoritetet përkatëse në Kosovë dhe do të shpërndahen me ndihmën e EULEX-it kudo që kërkohet. Secila palë do të bëjë përpjekje maksimale për implementuar si më lartë;
8.	Si masë e përkohshme, autoritetet në Beograd do t'ua mundësojnë automjeteve nga Kosova që bartin targat KS të qarkullojnë lirshëm në dhe përmes territorit të saj;
9.	Si masë kalimtare, për cilindo pronar automjeteve që dëshirojnë, do të vihen në dispozicion targa të përkohshme, në pikëkalimet kufitare/kufitare administrative.
10.	Përkritazi me riatdhësimin dhe duke marrë parasysh obligimet e Prishtinës në këtë fushë, pikat e marrëveshjeve më lartë nuk do të krijojnë obligime për palën e Beogradit për të pranuar kërkesat për ripranim për personat me dokumente të Kosovës në kuadër të marrëveshjes ekzistuese për ripranim ndërmjet Serbisë dhe BE.

të zbatojë, sa më shpejt që është e zbatueshme në aspekt operativ, një sistem të kalimit të kufirit/kufirit administrativ

të qytetarëve të palës tjetër me letërnjoftime". Pronari i kompanisë "Pikëllimi", Fatmir Elezi, i cili

ka pikat e kompanisë në të gjitha vendet e Evropës, si në Shtutgard, Dyseldorf, Frankfurt, Francë, Danimarkë, Suedi, Belgjikë dhe Austri, ka treguar për gazetën "Epoka e re" se para një jave ka sjellë në Kosovë gjashtë kufoma, por në asnjërin rast nuk kanë mundur që të kalojnë nëpër territorin e Serbisë. "Vetëm të hënën që lamë pas kompania ime ka sjellë gjashtë kufoma nga mërgata për në Kosovë dhe nuk kemi mundur të kalojmë nëpër territorin e Serbisë. Ne u kemi shënuar emal institucioneve vendore dhe jemi ankuar disa herë për këtë çështje, mirëpo ende nuk kemi marrë përgjigje nga asnjë ministër, qoftë i Punëve të Jashtme dhe as nga Ministria e Diasporës që ishte më herët", ka thënë ai. Elezi ka treguar se për këtë problem i ka shkruar letër edhe Glauk Konjufcës sa ishte ministër i Punëve të Jashtme. "Në kohën e pandemisë i kam shkruar letër edhe Glauk Konjufcës sa ishte ministër i Punëve të Jashtëm. Po ashtu edhe ish-kryeministrit Albin Kurti. Asnjëri nuk më është përgjigjur", ka thënë ai. Ai ka treguar për rastet kur shteti serb ka kthyer kufomat pas. "Një qytetar nga rrethi i Gjilanit para dy vjetësh ka vdekur në kufi me Serbinë dhe më pas i njëjti nuk është lejuar që të hyjë



në Kosovë”, është shprehur Elezi.

Pronari i kompanisë “Pikellimi”, Fatmir Elezi, këtë bllokadë që po e bën shteti serb e ka vlerësuar si trajtim çnjerëzor. “Moslejimi i kalimit nëpër Serbi me kufoma është më të vërtetë problem i madh që na sfidon në mërgatë prej vitesh. Numri i shqiptarëve që jetojnë në diasporë është i madh. Ju e patë edhe në rezultatin e votimit për zgjedhjet e 14 shkurtit. Shumica e atyre që jetojnë në diasporë që nga vitet '70 kanë edhe prindërit e tyre me vete. Nëse personi është me dokumentacion të Kosovës nuk lejohet që të qarkullojë nëpër territorin e Serbisë. Neve na duhet që të kalojmë nëpër vende të tjera alternative. Kompania ime mund të kalojë nëpër territorin e Serbisë vetëm kur bëjmë bartjen e kufomave për në Maqedoni dhe në Serbi. Kjo nuk na lejohet kur kemi të bëjmë me kufomat që duhet t'i sjellim në Kosovë. Maltretimi që na bënë Serbia nuk është njerëzor dhe është larg civilizimit që të ndalohet lëvizja. Kjo çështje urgjentisht duhet të diskutohet në Bruksel”, ka deklaruar ai.

Fatmir Elezi i ka bërë thirrje Ministrisë së Punëve të Jashtme, por edhe ligjvënësve të ardhshëm në Kosovë, që këtë çështje ta trajtojnë me prioritet dhe ta hapin si temë diskutimi në Bruksel. “Mos të harrojnë se në diasporë janë rreth dy milionë kosovarë”, u shpreh ai. Lidhur me këtë çështje gazeta “Epoka e re” ka dërguar pyetje edhe në Ministrinë e Punëve të Brendshme (MPB) e cila është edhe zbatuese e marrëveshjes për lëvizjen e lirë të automjeteve dhe qytetarëve, mirëpo në këtë ministri kanë thënë se për këtë çështje duhet

t'i drejtohem Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës. Megjithatë, gazeta nuk ka marrë përgjigje as nga Ministria e Jashtme e as nga zyra për informim e qeverisë aktuale.

Edhe Avni Elezi, pronar i kompanisë “Funerali-Elezi” që merret me transportin e kufomave nga mërgata për në Kosovë, ka thënë se problemi kryesor është leja për transit nëpër Serbi, e që kjo ndalesë nga ana e shteti serb u kushton si në aspektin financiar, po ashtu edhe në atë kohor. “Në këto raste kur Serbia nuk na lejon të lëvizim nëpër territorin e saj me kufoma, detyrohem që të shkojmë përmes Kroacisë, Malit të Zi, Shqipërisë dhe më pas të vijmë në Kosovë. E gjithë kjo na kushton si në aspektin kohor ashtu dhe atë material”, ka thënë Elezi.

Ndërkaq sa i përket ndihmës institucionale, ai ka thënë se këtë çështje e kanë adresuar disa herë te Ministria e Punëve të Jashtme, që aktualisht drejtohet nga Meliza Haradinaj-Stublla, por nuk u është ofruar zgjidhje deri më tani. “Kemi pasur biseda me shumë njerëz të institucioneve, por ende ky problem nuk është zgjidhur. Ne duhet të nxjerrim lejekalim nga Ambasada e Kosovës që kufoma të lejohet për t'u varrosur në Kosovë, si dhe leje-transit nëpër të gjitha shtetet nga duhet ta transportojmë kufomën. Kroacia dhe të gjitha shtetet e tjera, edhe Mali i Zi na lejojnë që të kalojmë andej, veç Serbia jo”, ka deklaruar Elezi.

Ai ka thënë se me këtë sfidë janë përballur shumë edhe në kohën e pandemisë, meqenëse linjat ajrore për një kohë ishin të pezulluara. “Me këtë sfidë jemi përballur shumë në kohë pandemie, pasi ka fluturime shumë pak dhe ka ndodhur që

për një kufomë me prit me javë. Momentalisht prej Gjermanisë s'ka aeroplanë që shkojnë direkt, pra që marrin kufoma Gjermani - Prishtinë, vetëm Gjermani-Stamboll-Prishtinë”, u shpreh ai.

Një qytetare nga Peja ka treguar për gazetën “Epoka e re” për transportimin e familjarit të saj të vdekur nga Austria. N. Morina ka thënë se familjari i saj, i cili vdiq në Austri është transportuar nga një kompani

turke për në Kosovë dhe nuk është lejuar që të kalojë nëpër territorin e Serbisë dhe si rrjedhojë i është dashur që të paguajë më shumë për transport të kufomës. “Nipi ynë ka vdekur në Austri dhe nga atje është bartur për në Kosovë nga një kompani turke. Ai nuk është lejuar që të kalojë nëpër Serbi për shkak se kishte dokumentacionin se do të varrosej në Kosovë. Prandaj, ne jemi detyruar që të paguajmë më shumë për bartje të kufomës dhe procedura ka zgjatur tri ditë derisa ka ardhur në Kosovë”, u shprehur ajo.

Nga Bashkësia Islame e Kosovës (BIK) kanë apeluar që mërgata të bëhet anëtare e Bashkësive Islame shqiptare ku ata veprojnë, në mënyrë që ta kenë më të lehtë orientimin e tyre për transport sa më të shpejtë në Kosovë. Abedin Sadriu, zyrtar për çështje fetare në Bashkësinë Islame të Kosovës, ka thënë se kjo është çështje politike dhe duhet të zgjidhet në kuadër të dialogut me Serbinë. Ai ka thënë se Bashkësia Islame e Kosovës nuk ka pasur bashkëpunim me Bashkësinë Islame në Beograd dhe si rrjedhojë s'mund të kenë ndikim në këtë drejtim.

Sadrriu ka thënë se kompanitë të cilat merren me transportin e kufomave nga diaspora nuk e kanë adresuar këtë çështje ndonjëherë në BIK. “Ky është problem politik dhe ne s'kemi qasje sepse kjo është çështje politike. Apriori shqiptarët duhet të jenë anëtarë në organizatat fetare. Ky shqetësim

nuk na është shfaqur nga kompanitë transportuese deri më tani. Është telashe sepse janë dy bashkësi fetare. Bashkësitë fetare që janë në Serbi, njëra me seli në Beograd, kurse tjetra në Sanxhak. Me këtë të Sanxhakut kemi bashkëpunim, kurse me të Beogradit jo. Ne e kemi Bashkësinë Islame Fetare në Zvicër dhe Gjermani të cilat pothuajse me çdo shtet kanë bashkëpunim, mirëpo është një problem sa i përket mërgatës sonë, pasi jo të gjithë janë të anëtarësuar në këto organizata joqeveritare. Në Zvicër e kemi bashkësinë islame fetare shqiptare. Atje ishin dy organizata, mirëpo tani është vetëm një dhe janë bashkuar dhe e kanë vetëm një organizatë islame fetare që përfshinë shqiptarët e Kosovës, Maqedonisë dhe Shqipërisë. E përsërisë se mërgata jonë ende nuk e ka në ndërdije të plotë që, të paktën, të regjistrohet si anëtare në një bashkësi fetare që i përkasin religjionit të caktuar, sepse kur t'u ndodhë rasti i vdekjes të dinë më pas si të veprojnë. Nëse e lajmërojnë rastin janë kompanitë e kontraktuara që e bëjnë një pagesë edhe ata e marrin përsipër që ta sjellin kufomën deri në adresën e caktuar”, u shpreh ai për gazetën “Epoka e re”.

Fituese e zgjedhjeve të 14 shkurtit ka dalë Lëvizja Vetëvendosje, e drejtuar nga Albin Kurti. Ky i fundit ka thënë se dialogu do të jetë prioritet i katërt, pas punësimit dhe drejtësisë.



Pritet të rifunksionalizohet Kinemaja e Qytetit dhe Ansambli i Këngëve dhe Valleve në Mitrovicë

MITROVICË, 23 SHKURT (ER) - Në ambientet e Qendrës së Kulturës "Rexhep Mitrovica" drejtori për Kulturë, Rini dhe Sport, Tafil Peci, ka mbajtur takim pune me stafin dhe institucionet vartëse të DKRS-së. Në këtë takim të pranishëm ishin stafi i DKRS-së, stafi i Muzeut të Qytetit, stafi i Palestrës së Sportit "Minatori", stafi i Bibliotekës së Qytetit "Latif Berisha", stafi i Qendrës së Kulturës

"Rexhep Mitrovica", si dhe stafi i Teatrit të Qytetit "Muharrem Qena". Gjatë këtij takimi drejtori Peci ka potencuar problemet me të cilat po ballafaqohen institucionet vartëse, sidomos te mungesa e drejtuesve të këtyre institucioneve, për çka theksoi se tash e tutje këto institucione do t'i kenë personat përgjegjës të cilët do të jenë urë lidhëse dhe të

gjitha problemet të cilat i kanë duhet t'i drejtojnë te ta. Peci u zotua se gjatë gjashtëmujorit të parë të këtij viti do të rifunksionalizohet Kinemaja e Qytetit dhe Ansambli i Këngëve dhe Valleve të Qytetit, duke theksuar se janë iniciuar procedurat për rifunksionalizim dhe gjatë këtij viti qyteti i Mitrovicës do të jetë i kompletuar me institucionet kulturore.



Kryetari i Degës së AAK-së në Gjilan jep dorëheqje



Gjilan, 23 shkurt (ER) - Agim Zuzaku, kryetar i Degës së Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) në Gjilan, ka dhënë dorëheqje nga kjo pozitë, pas rezultatit të zgjedhjeve të 14 shkurtit të kësaj partie. Në letrën e dorëheqjes që ia ka dërguar liderit të AAK-së, Zuzaku ka treguar arsyen e dorëheqjes. "Pas çdo procesi zgjedhor nëse ka rezultate të mira

duam t'i marrim meritat, por duhet marrë përgjegjësinë edhe për këto rezultate shumë zhgënjyese", shkruan Zuzaku në letrën e dorëheqjes. Ai ka shprehur zhgënjimin e tij në nivelin qendror të partisë për disa arsye. "Nuk ka funksionuar shtabi. Të rinjtë janë keqmenaxhuar me ose pa qëllime të caktuara. Jam

munduar ta ruaj unitetin nëpër nëndegë dhe në degë. Shumë gjëra jam munduar të mos i shoh e kuptoj për të vetmin qëllim. Ndoshta po bëjmë diçka mirë e po arrijmë sukses por, jo. Kulmi i gjithë procesit ishte kur niveli qendror nuk i ka kryer obligimet për vëzhgues duke më lënë në pozitë më të palakmueshme të jetës time", ka shkruar Zuzaku.

Si pasojë e vozitjes së shpejtë të automjeteve, në fshatin Dumnicë do të vendosen pengesa

PODUJEVË, 23 SHKURT (ER) - Kryetari i Komunës së Podujevës, Shpejtim Bulliqi, së bashku me drejtorin e Planifikimit Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit, Bujari Hasani, kanë vizituar rrugën "Dëshmoret", që shpie nga Podujeva në fshatin Dumnicë, ku si pasojë e vozitjes së shpejtë të automjeteve, po rrezikohet jeta e qytetarëve që banojnë pranë kësaj rruge. "Aty pashë nga afër dëmtimin e murit e oborrit të një shtëpie

nga përplasja e një veture si pasojë e shpejtësisë së madhe. Me qëllim të ruajtjes së jetës dhe për sigurinë e qytetarëve tanë, në bashkëpunim me drejtorët e drejtorive përkatëse, vendosëm që menjëherë të vendosen pengesa në atë rrugë (të ashtuquajturit policë të shtrirë) dhe të fillojmë procedurat për ndërtimin e trotuarit dhe ndriçimit publik përgjatë këtij segmenti rrugor", ka thënë Bulliqi.



Gjini premtion përkrashje për OJQ-të

Gjakovë, 23 shkurt (ER) - Kryetari i Komunës së Gjakovës, Ardian Gjini, ka zhvilluar takim me përfaqësuesit e shoqërisë civile me qëllimin e vetëm që funksionimi i tyre të jetë i ndërlidhur edhe me komunikimin sistematik dhe ndërveprimin me institucionet lokale. Përfaqësuesit e OJQ-ve në këtë

takim, Arbër Lleshi, ka theksuar që organizatat joqeveritare duhet të funksionojnë si mekanizëm dhe fjalët të kthehen në aksione. Shumica e përfaqësuesve të organizatave sfidë e shohin qëndrueshmërinë e projekteve. Ndërkaq kryetari Gjini ka shprehur gatishmërinë e plotë që t'i mbështesë projektet që

janë në interes të qytetarëve, me theks të veçantë për grupet e marginalizuara dhe OJQ-të që ofrojnë shërbime. Ai ka thënë se gjatë vitit komunës i lirohen hapësira që janë në pronë komunale e të cilat do t'u ofrohen OJQ-ve si mundësi e mirë për zhvillim dhe mbështetje e drejtpërdrejtë komunale.



Unioni Humanitar Shqiptar në Graz të Austrisë ndihmon dy familje në Drenas



DRENAS, 23 SHKURT (ER) - Kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci, ka falënderuar Unionin Humanitar Shqiptar në Graz të Austrisë për solidaritetin dhe kontributin e tyre për t'i ndihmuar familjet në nevojë në këtë komunë. Unioni Humanitar Shqiptar në Graz në

vazhden e ndihmës humanitare në Kosovë, së fundmi ka ndihmuar edhe dy familje nga Drenasi, përkatësisht familjen Uka nga Gradica me 500 euro dhe familjen Selmani nga Pokleku i Ri me 300 euro. Komuna e Drenasit ka

falënderuar vullnetmirët dhe shoqatën, të cilët po kontribuojnë që qytetarët të kenë mirëqenie sociale e ekonomike. Ndërsa Unioni Humanitar Graz ka vlerësuar Drenasin për performancën e mirë dhe transparencën ndaj qytetarëve.

KADARE DHE KOSOVA (2)

KADARE ËSHTË HAPËSIRË E KRIJUAR PËR KOSOVËN



Bedri ISLAMI

Plini plak, në të famshmen "Naturalis Historiae", sjell dëshminë për një burrë të zakonshëm, Straboni, që kishte një aftësi të jashtëzakonshme. Ky njeri u bë i famshëm sepse duke qëndruar mbi Kepin Limbeu të Sicilisë arrinte të shikonte brigjet e Kartagenës, rreth 200 kilometra larg dhe sinjalizonte saktësisht lëvizjet e anijeve luftarake që dilnin nga portet kartagenase për ta sulmuar flotën romake. Të gjithë krahasimet çalojnë, thonë gjermanët, ndoshta edhe krahasimi im është i mangët, pasi Kadare nuk është një burrë i zakonshëm, por njëri nga shkrimtarët më të shquar të shekujve ku jetoi por, si Straboni i Plinit plak, që në gjenezën e saj dalloi krimin serb mbi Kosovë. E bëri këtë si askush tjetër dhe në lartësi ku nuk mund të shkonin të tjerët, ose fjala e tyre nuk kishte të njëjtën mençuri dhe mirëbesim.

Në korrikun e vitit 1989, i ftuar në Elize, për mëngjes, nga presidenti francez Mitteran, ndoshta njëri nga kujtimet e çmuara të shkrimtarit, Kadare, pa asnjë ngurrim, është i bindur se duhet thënë e vërteta dhe ky është vendi i duhur, pasi përballë tij është një nga mendjet më iluministe të kohës, evropian i shquar dhe një njeri i ndërgjegjes dhe kulturës botërore, por edhe përfaqësuesi i një kombi që shpeshherë ka mbyllur sytë ndaj krimin serb në gadishullin e vjetër ballkanik.

Është e vështirë të gesh hapësirën në një bisedë ku, krijimi si dhunti dhe përpjekje, është ftesa e menduar si e tillë dhe, në vend të tyre, t'i sjellësh çështjet e vështira etnike, me ndërlikime të papritura, të cilat mund të prishin, apo të supozohet se mund të prishin, harmoninë e arritur me aq vështirësi e, megjithatë, kjo duhet bërë. Nuk ka asnjë njeri tjetër kombi që mund ta bëjë këtë. Në Shqipërinë londineze ku diktatura është në rrokopujë, pak vetë e kanë mendjen te Kosova, që duket e largët, e befte dhe përtej mjegullave. Në Kosovë, viti 1989 është ende nën rëndesën e zakonshme të krimin shtetëror serb, që tani bëhet edhe më i rëndë e mizor, pasi është piku i kohës së Millosheviqit dhe lëvizjet e mëdha të shqiptarëve, të filluara që nga viti 1988, do të kenë kulmin e tyre, të cilat do të ndodhin disa muaj më vonë, nëntorin e vitit 1989. Një nga të vrarët në Kodrën e Diellit, më 2 nëntor 1989, do të jetë lideri kryesor i lëvizjes çlirimtare. Quhej Afrim Zhitia. Një djalë i hequr në fytyrë, me syze, organizator i shkëlqyer, lexues i madh.

Në lëvizjen ilegale ka marrë një emër të dytë. Quhet Ismail. Frymëzuar nga Ismail Kadare do të

bartë emrin e tij të luftës deri në ditë të mërkurës së tij. Nipit do i vë emrin Dritëro.

Kadare, që nuk besoj ta ketë ditur këtë fakt real, ndoshta deri ditën që në një bisedë të gjatë në Tiranë i foli për Afrim Zhitinë, është ndoshta nga të vetmit, emrin e të cilit në luftë e kishte një ndër heronjtë më të shquar të saj.

Është njeriu i vetëm që, i adhuruar në kombin e tij, është po aq i adhuruar edhe në Francë; i lexuar nga të gjithë, që nga të burgosurit politikë që presin vajtjen e tij mes tyre, deri te presidenti i mençur francez. Kombi i heshtur ka ndërgjegjen e tij, kjo ndërgjegje nxjerr një zë, i cili ka, në të njëjtën kohë, edhe vështrimin e mprehtë. Kush bart këtë vështrim, sheh të vërtetën, atij i nënshtrohet e drejta për ta shpallur atë.

- Sado që një gjë e tillë tingëllon mesjetare dhe e kapërcyer nga koha, më besoni, Zoti President, se në Gadishullin Ballkanik mesjeta është ende e pranishme. Unë ju lutem që ta vlerësoni këtë paralajmërim, këtë klithmë për ndihmë, përpara se tragjedia të ndodhë dhe përpara se të jetë vonë. Dhjetë vjet më vonë tragjedia ndodh. Ajo do të kishte qenë më katastrofike, nëse nuk do të kishte qenë zëri i një njeriu që, shumë kohë më përpara, ka guxim dhe burrërinë, jo vetëm të hulumtojë, por edhe të shpallë atë që botës i dukej e largët, e mistershme dhe e pabesueshme.

Është viti 1989. I njëjti kur, me mikun e tij, laureatin e çmimit Nobel të Paqes, Elia Weisel, i shkruan presidentit amerikan Georg Bush, kur diktatura ishte ende në këmbë dhe, dihej nga të gjithë se, binaja e madhe në të shembur e ka rrezikun dhe ai vetë, nëse do të dihej ky letërskrim, do të ishte nën pluhurin e gërmadhës, apo edhe më tej, i dënuar me vdekje. Ai e ndien për detyrë t'i shkruajë presidentit të shtetit më të fuqishëm të botës, përsëri në shtatorin e vitit 1991, duke bërë paralajmërimin tragjik. "Dhurata që iu bë terroristëve serbë..., duke iu dhënë si shpërblim gjysmën e Shqipërisë, është një nga krimet më të mëdha në historinë e njerëzimit. Sa më shpejt që bota e qytetëruar ta çlirojë veten e saj nga ky krim, aq më mirë do të jetë".

I pamat është pasioni i Kadaresë për Kosovën. Ai e ka dashur atë në të gjitha stinët e jetës së tij, shumë më tepër nga çka mund të merret me mend. Është një dashuri pasionante mes poetit numër një të kombit dhe vuajtjes më të madhe të tij. Rrallëherë është ndeshur një përkushtim i tillë, deri në vetëvuajtje: në çështjen e Kosovës ai është më vizionar se të gjithë artistët, të gjithë njerëzit e politikës, në të gjithë trojet shqipfolëse; ai e ndien deri thellë në veten e tij vuajtjen e saj, e përkëdhel atë, e rrok, e dëshmon, përgjërohet, ndien ngashërim, rri i pagjumë, shkruan, dërgon mesazhet e tij kudo ku mund të jetë i pranishëm dhe është i pranishëm kudo;

shqetësohet për krenarinë e bosht shqiptare, por edhe përcakton saktësisht atë çfarë po ndodh në Kosovë; ai saktëson ngjarjet e vitit 1981 më qartë se secili prej nesh, i sjell tronditshëm në dy romanet e tij, një nga të cilët "Krushqit janë të ngrirë", tronditi të gjithë piramidën e shtetit ku jetonte, edhe më përtej saj, tërmetoi, nëse kjo është fjala e duhur, një botë tjetër, atë të shtypjes, nxori nga kafazet e pista gjëmën e kolegëve shkrimtarë, të cilët e akuzuan rreptë, duke e ndier më shumë se kushdo tjetër se ai, pikërisht ai, shkrimtari i namun, si Bjeshkët e Veriut, do të ishte në të njëjtën kohë gjëma e tyre, piskama e krimin që kishte ndodhur dhe po ndodhte.

Kadare është hapësirë e krijuar për Kosovën. Hapësirë, vende-vende si rrafshulëtat e saj dhe më së shumti si rrafshlartat e Kosovës. Tek ai njeriu gjen fushën e Dukagjinit dhe bjeshkët e Sharrit, përdëllimin e ndjenjës ndaj asaj pjese të kombit, në skajin tjetër, që vuan, përpëlitet,



gjakoset, shtypet, ngrihet përsëri, trazohet shpreson, ëndërron, ndien se si i përgjaket ëndrra dhe kërkon një dishepull të lirisë, ama një dishepull të madh dhe e gjen këtë te Kadare.

Ai i përkëdhel plagët kur duhet, por edhe i zbulon ato, me qartëpamësi të habitshme, që vjen nga një thirrje e brendshme, e furishme, e paepur dhe, duke qenë më i përkryeri nga rrëfimtaret tanë dhe një nga më të mrekullueshmit e botës, ai është edhe më real.

Kur një herë, në një ndjenjë në Tiranë, po i tregojta se sa me ankth dhe, në të njëjtën kohë, me ngazëllim priteshin deklaratat e tij në ditët e luftës në Kosovë dhe se, asgjë tjetër, asnjë deklaratë zyrtarësh, politikanësh, qeveritarësh të lartë nuk pritej dhe nuk kishte ndikim si fala e tij, ai më tha se askush nuk i kishte thënë se duhej të vepronte ashtu, gjithçka i kishte ardhur nga brenda, kishte qenë shtysa e tij, vetëdija, bindja, rruga që kishte zgjedhur, meraku i madh dhe dëshira për të qenë sa më i pranishëm.

Ai, për Kosovën, ka ngritur një konstruksion të mahnitshëm me gjerësi dhe gjithanshmëri të pazakontë; për këtë ai nuk ka thirrur në ndihmë asgjë tjetër, veçse përjetimit të tij, njohjes së thellë të shpirtit të popullit të tij dhe dëshmitë e brezave ballkanikë: është i paanshëm, ndaj i besuar; frymëdhënës, ndaj jetësor; i shpejtë, do të thotë në kohën e

duhur; i përpiktë, sepse është gjenial; tokësor, sepse e ndien dhimbjen; i pazakontë, pasi përcaktimet e tij i takojnë së ardhmes.

Në kohën kur i gjithë arsenalin medial e politik i shtetit serb e quan Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës një aksiomë terroriste me theks islamik, dhe jo rrallë gjen vend edhe në median e Kosovës, e shtrydhur nga shitja; dhe kur media në Shqipëri, më tepër ironizon sesa e kupton luftën, ai, Kadare, bën dy përcaktime të sakta, frymëdhënëse dhe ushtuese edhe përtej shtetit shqiptar. "Kur një popull ndodhet në gjendjen e një grigje të pambrojtur përballë ujkut, ëndrra e tij më sublimë është shfaqja e një shpëtimtari e një dalzotësi. Kur populli i Kosovës u gjend kështu, grigje e pambrojtur përpara kasapit serb, UÇK-ja u bë dalzotëse e saj... Askush s'mund t'ia heqë dot kurrë asaj emrin e madh dalzotës".

Vetëm ata që kanë qenë pjesë e luftës e dinë se sa përcaktuese ishin

Kadare është dëshmia e besueshme. Kjo dëshmi duhet djegur!

Kadare është e vërteta dhe e bukura. Këto duhen nxirë!

Vuk Drashkoviç, më i njohuri prej tyre, shkrimtar e politikan, do t'i shkruante Ismail Kadaresë më 18 qershor 1987: "Ju shpesh deklaroni, se ngjyra e kuqe e flamurit shqiptar simbolizon gjakun që pandërprerë duhet të derdhet për bashkimin e të gjithë shqiptarëve, kurse ngjyra e zezë shënon zinin për heronjtë, të cilët do të fllojnë jetën për këtë qëllim të shenjtë".

Interesant është se edhe një studiues shqiptar, Sabri Hamiti, megjithëse e di krejt mirë se shkrimtari Kadare ka botuar më shumë se 1 000 faqe për Kosovën, në disa gjuhë të botës, se romani i tij "Krushqit janë të ngrirë" është tronditës për qeverinë serbe, sa që detyrohet të nxjerrë Drashkoviçin e të dërgojë letra e artikuj kudo për të denigruar të vërtetën, ai, Hamiti, bashkohet me këtë zë të Vukës dhe e cilëson

"një roman pa vlerë".

E pabesueshme për filozofët, shkrimtarët dhe politikanët serbë, por Kadare nuk është nacionalist. Asnjë dell nacionalizmi nuk ka në veprën e tij. Asnjëherë ai nuk merr pozën e një nacionalisti dhe nuk kërkon shtizë për flamurin e tij të urtësisë.

Kadare është një njeri i letrave, për të cilin nuk janë të panjohura raportet e tmerreve të rrokshme me ato të përfytyrimit; tek i cili ndjenja për kombin e tij nuk kalon nëpër gardhet e prishura të kombeve të tjerë; adhuroes i gjuhës së tij, ai bën vend për lartësimin e vlerave njerëzore; e keqja e trondit, por nuk e zmbars; nuk ndjell kore fantazmash, por si në tragjeditë e lashta greke e vërteta ka zënë vendin e korit dëshmues; thelbi i fjalës së tij është Kosova në hallet e saj dhe pamundësinë e njerëzores nga një shtet çnjerëzor, por kurrë denigrimi i atij tjetrit, kushdo të jetë; mbrojtës i vlerave sipërore, ai nuk bie në batakun e përbuzjes dhe të urrejtjes, ndaj është më i besuar në kancelaritë e larta të botës më shumë se kolegët e tij serbë; ai nuk blen mashttrimin dhe nuk e shet të vërtetën - kjo përbën rrënjën e një shkrimtari serioz, hijerëndë, qartësisht largpamës.

Viti 1980 do të jetë në Kosovë viti i Kadaresë. Sapo është botuar korpusi i Veprave të tij në dhjetë vëllime dhe, i ftuar nga Azem Shkreli, poeti i shquar, që i kishte kushtuar Kadaresë poezinë e tij magjike "Përshëndetje me miq", Plot fjala është me ju, plot kupa, plot gjiri i nënës,

Kudo e ngado është juaja, pos mohit, por orës së prapë, Dhe krismës prapa shpinës, po unë me se

Të ju zbukuroj në Baladë, o mik, me se, o dega ime e epërt e Fisit....

Ju falem që jeni, o të mirë, ju falem që jeni, jo falem,

Plot fjala është me ju, plot kupa, plot gjiri i nënës. (Vijon)

prononcimet e Kadaresë në një kohë të tillë dhe, njëkohësisht, sa frymëzuese.

Pikërisht ato ditë, përcaktimi i Kadaresë ishte më i vyer se qindra deklaratat politike të selive në Tiranë a Kosovë.

Kadare merr mbi vete rolin dhe misionin e artistëve të mëdhenj të kombeve që synonin lirinë, si të Shilerit, Gëtes, Bernsit; ai vringëllon me nervin e tij të furishëm në shkrimet e tij si Dostojevski; bën analizën e milimetruar të ngjarjeve dhe personazheve si Balzaku; zbrit në ferrin e krimin terrorist serb si Dante; ai është në luftë pa qenë në front, ngjall kuptimin e lirisë si Pëtef, sjell tragjeditë si në skenat shekspiriane; pra është një nga si vëllezërit e tij, pararendës të lirisë.

Ai ndërton për Kosovën kufijtë e artit të tij, që nuk janë arritur deri më tani nga askush tjetër nga përsosmëria e shprehjes, tragjizmi i jetuar dhe, nëse ka një njeri që nuk tronditet nga vrasja e Gërvalljave, paraqitur madhërisht në romanin e tij kronikë, atëherë ai nuk do të mund të kuptojë kurrë të vërtetën e asaj që ka ndodhur.

Prania e Kadaresë ngjall alarim në shtetin serb, në piramidën e tij, në të gjithë atë sistem zinxhiror strukturash ku krimi projektohet të paraqitet si mirësi, ku gjaku nuk ka ngjyrën e kuqe, dhe shteti i thërret në ndihmë të gjithë kundër Kadaresë.

Kadare është memorja. Kjo memore duhet zhdukur!

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'**
TEL: 045/82 82 82

Prishtina kërkon fitoren e tretë radhazi ndaj Dritës

Sot në stadiumin "Fadil Vokrri" zhvillohet derbi i javës së 21-të në elitën e futbollit të Kosovës në mes të Prishtinës dhe Dritës. Po nga ora 13:00 në program janë edhe dy ndeshjet e tjera për këtë xhiro: Gjilani - Ballkani dhe Trepça '89 - Llapi



analizuar dhe do ta kemi të vështirë të përballemi në mënyrën e mëhershme. Është ndeshje tejet e rëndësishme dhe nëse na del mirë në stërvitje mund të ndryshojmë sistem për të mërkurën.

Drita në ndeshjen e fundit është befasuar nga Trepça '89, pasi pësoi humbje në Gjilan me rezultat 1-2. Për ndeshjen ndaj prishtinasve ka folur edhe

mbrojtësi i Dritës, Adrian Cuculi. Ky i fundit është optimist se kampionët janë në gjendje ta dëshmojë forcën e tyre ndaj një kundërshtari të fortë siç është Prishtina. "Brenda një periudhe shumë të shkurtër kemi luajtur kundër Prishtinës dy ndeshje dhe tashmë është ndeshja e tretë. Kjo ndeshje vjen pas një dështimi të vogël në shtëpi dhe është momenti ta tregojmë forcën tonë

SUPERLIGA - Java 21

Të mërkurën takohen:
13:00 Gjilani - Ballkani
13:00 Trepça '89 - Llapi
13:00 Prishtina - Drita

Të enjten takohen:
13:00 Feronikeli - Drenica
13:00 Besa - Arbëria

të kampionit në ndeshjen ndaj një skuadre të fortë siç është Prishtina", ka thënë Cuculi.

Aktualisht Prishtina është e treta me 38 pikë, kurse Drita zë vendin e dytë me 44 pikë. Sot (e mërkurë) do të zhvillohen edhe dy derbi të tjerë në elitë. Gjilani i Bylbyl Sokolit e kërkon këndelljen ndaj liderit të re në renditjen tabelore, Ballkanit, kurse Llapi kërkon edhe një tjetër sukses në sezonin pranveror, kësaj radhe ndaj Trepçës '89 në "Riza Lushta".

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 23 SHKURT - FC Prishtina, pas dy fitoreve në ndeshjet e fundit kundër Dritës, synon ta marrë edhe fitoren e tretë dhe në këtë mënyrë të ecë drejt titullit kampion në Superligën e Kosovës në futboll. Në fakt, sot (e mërkurë) nga ora 13:00 në stadiumin "Fadil Vokrri" skuadra kryeqytetase e pret kampionen në fuqi, Dritën. "Skuadra nuk ka probleme në përbërje. Pritet edhe rikthimi i Lilajt dhe duke e parë se si skuadra po gëzon formë maksimale, atëherë nesër mund

të presim angazhim maksimal dhe që skuadra të dëshmojë se dy fitoret për Kupë dhe Superkupë ndaj Dritës nuk kanë qenë të rastësishme", thuhet në njoftimin e Prishtinës.

Ndërsa trajneri Zekrija Ramadani ka paralajmëruar ditë më parë se në ndeshjen e radhës kundër Dritës do të provojë një skenë të re për faktin se gjilanasit tashmë mund ta kenë studiuar lojën e Prishtinës: "Ndeshjet me Dritën gjithmonë janë të forta edhe kur kemi pasur tre përballje rresht në kohë të shkurtër. Do të punojmë në këto katër ditët e ardhshme për një skemë më ndryshe, sepse besoj se Drita tani më mirë na ka

Atalanta e gatshme ta befasojë Realin

Bergamo, 23 shkurt (ER) - Një përballje shumë interesante do të zhvillohet në Ligën e Kampionëve mes Atalantës dhe Real Madridit në "Gewiss Stadium". Skuadra që drejtohet nga Gian Piero Gasperini përfundoi e dyta në Grupin D për të siguruar një vend në fazën e eliminimit direkt, kurse Reali, edhe pse nuk e nisi mirë këtë edicion në Ligën e Kampionëve, e mbylli në vendin e parë të Grupit B. Për nga historia Real Madridi është favorit absolut për të fituar këtë ndeshje dhe për t'u kualifikuar tutje, por ngritja e madhe e Atalantës në vitet e fundit dhe entuziazmi mund të sjellin befasi. Klubi italian në edicionin e kaluar është eliminuar nga PSG-ja në çerekfinale, por tash gjerat janë ndryshe dhe skuadra italiane synon ta dënojë skuadrën e Realit që po ka probleme me lëndime të futbollistëve. Ndërsa Reali që është skuadra më e suksesshme në këtë garë, nuk e nisi këtë edicion në mënyrën më



të mirë, por më pas trajneri Zinedine Zidane i vendosi gjërat në binarë duke përfunduar të parët në grup, kurse në këtë ndeshje synojnë të marrin një rezultat pozitiv para ndeshjes së kthimit. Mungesa e vetme e Atalantës në këtë ndeshje është Hans Hateboer, kurse Reali do të jetë pa Karim Benzeman, Eden Hazardin, Rodrygon, Sergio Ramosin, Marcelon, Eder

Militaon, Daniel Carvajalin dhe Federico Valverden, të cilët janë të lënduar. Ndërsa mesfushori Casemiro është i pezulluar. Sonte zhvillohet edhe një ndeshje tjetër në Ligën e Kampionëve në mes të Borussia Monchengladbachut dhe Manchester Cityt në "Puskas Arena". Kjo është hera e parë që Gladbach është kualifikuar në këtë fazë, ndërsa City po kërkon

ta fitojë garën për herë të parë në historinë e klubit. Klubi gjerman nuk ka shqetësime për mungesat, ndërsa anglezët nuk do të kenë vetëm mbrojtësin Nathan Ake.

Të mërkurën takohen:
21:00 Atalanta - Real Madrid
21:00 Borussia Moenchengladbach - Manchester City

KF Drenica dhe trajneri Devolli, në disiplinore

PRISHTINË, 23 SHKURT - Komisioni i Garave i Federatës së Futbollit të Kosovës (FFK) ka iniciuar procedurë disiplinore ndaj skuadrës së Drenicës dhe trajnerëve Bledar Devolli dhe Skënder Mustafa. Pas ndeshjes me Besën, Devolli kishte tentuar të përleshet me zyrtarët dhe futbollistët e klubit pejan. Ndërkaq, Drenica mund të dënohet për lëshim në organizimin e ndeshjes ndaj Besës. Ndërsa ndihmëstrajneri Mustafa mund të dënohet pasi e ka kapur për fyti lojtarin e Besës, Agon Xhaka.




Marku: Do ta jap shpirtin për t'u bërë kampion bote

LONDËR, 23 SHKURT - Florian Marku arriti një fitore të madhe ndaj Rylan Charltonit, duke u konfirmuar edhe një herë një nga më të mirët në Angli

dhe i ka dhënë mundësinë vetes të ngritet një tjetër shkallë në boksing anglez. Marku ka publikuar një video emocionuese në internet, ku shfaqet biseda e

tij me Rylan Charlton para ndeshjes, teksa gjithë fjalët e Markut në atë intervistë u materializuan në ring, ku kundërshtari u dorëzua në raundin e nëntë. Në

përshkrimin e videos, Marku shpall ëndrrën e tij, ku shkruan: "Unë ju premtoj të gjithëve se do ta jap shpirtin derisa të arrij ëndrrat e mia, të shpallëm kampion bote".



Në gjysmëfinale takohen BB Llapi - Liburni dhe Liqeni - Prishtina

PRISHTINË, 23 SHKURT - Janë zhvilluar ndeshjet çerekfinale të Kupës së Kosovës në futsall. Ndeshja më interesante e këtij rrethi ishte ajo në kryeqytet ndërmjet Prishtinës 01 dhe

Liburnit, e cila në kohën e rregullt u mbyll baras 3-3, derisa pas penalltive në gjysmëfinale kaloi skuadra gjakovare (5-3). Në ndeshjet e tjera u arritën kryesisht

rezultate të pritura. Në gjysmëfinale do të takohen: BB Llapi-Liburni dhe Liqeni-Prishtina. Ndeshjet e këtij rrethi zhvillohen me sistem vajtje-ardhje, ku takimet e

para luhen më 27 e 28 shkurt, derisa ato të kthimit më 8 e 9 mars. Rezultatet: Liqeni-Peja (2-0), Prishtina 01-Liburni (3-3, 3-5, pas penalltive), Prishtina-Albaniku (5-0),



Sot dy ndeshje në Superligën e basketbollit

PRISHTINË, 23 SHKURT - Pas garave të Kupës dhe dy ndeshjeve të Përfaqësueses së Kosovës, në mesjavë do të zhvillohet xhiroja e 20-të në Superligën e Kosovës në basketboll, ku pritet të ketë disa përballje interesante. Sigal Prishtina, pasi fitoi Kupën e Kosovës, është e motivuar dhe do të përballet me Vëllaznimin, skuadër që ka bërë disa ndryshime, me synim për të mbijetuar. Prishtinasit kanë 25 pikë, dy më shumë se kuqezinjtë që ndodhen në vendin e fundit në renditje.

Rahoveci-Trepça, po ashtu, është takim interesant. Vreshtarët kanë grumbulluar 31 pikë, ndërsa mitrovicasit në stinorin pranveror janë këndellur dhe kanë 25 pikë, derisa qëllimi i vetëm mbetet mbetja në elitën e basketbollit. Të enjten do të përballet skuadrat prizrenase Ponte Prizreni - Bashkimi, apo të vetmet që nuk kanë ndërruar trajnerët në këtë edicion. Ponte



ndodhet në pozitë më të mirë, pasi ka grumbulluar 32 pikë, kurse Bashkimi ka 29, dhe synon "play-off"-in. Dueli i fundit, por më interesanti është ai në mes të Pejës dhe Golden Eagle Yllit. Këto dy skuadra pasi nuk arritën të fitojnë Kupën, do të përqendrohen 100 % në kampionat, me synimin për të triumfuar në fund. Pejanët ndodhen në vendin e tretë me 31 pikë, kurse therandasit janë

SUPERLIGA - Java 20

Të mërkurën takohen:
15:00 Sigal Prishtina - Vëllaznimi
17:00 Rahoveci - Trepça

Të enjten takohen:
15:00 Ponte Prizreni - Bashkimi
17:00 Peja - Golden Eagle Ylli

në vendin e parë me një pikë më shumë.

Lakersat, në krizë rezultatesh, Utah, në superformë

SALT LAKE CITY, 23 SHKURT - Çaste jo të mira për kampionët në fuqi të NBA-s. Los Angeles Lakersi pësoi humbjen e tretë rresht dhe të katërtën në pesë ndeshjet e fundit teksa u mposht pas kohës shtesë nga Washington Wizardsi me rezultatin 124-127 brenda në "Staples Center". Një humbje që djeg kjo pasi i zbriti Lakersat në vendin e 3-të në Konferencën e Perëndimit pas Utah Jazz dhe rivalëve të Los Angeles Clippersit. Vijon momenti i artë, ndërkohë për skuadrën kryeqytetase me Wizardsin që morën fitoren e 5-të radhazi. Dallimin në sfidën e Staples Centerit e bëri dyshja Bradley Beal-Russell Westbrook. I pari koleksionoi në total 33 pikë, 7 rebounde dhe 6 asistime, ndërkohë që Westbrook u afrua shumë triple-double me 32 pikë, 14 rikuperime poshtë tabelës dhe nëntë pasime deçizive.

LeBron Jamesi nuk mundi të evitonte i vetëm humbjen e La Lakersit edhe pse arriti të koleksiononte 29 pikë, 9 rebounde dhe 13 asistime, me kalifornianët që ndienë mungesën e dy yjeve të tjerë të skuadrës Antony Davis dhe



gjermanit Denis Schroder. Nuk njih limite në këtë sezon Utah Jazz që mori fitoren e 21-të në 23 ndeshjet e fundit, pasi mposhti lehtësisht në "Salt Lake City" me rezultatin 132-110 Charlotte Hornets. Tri periodat e para ishin thuajse të baraspeshuara, ndërkohë që diferencën Utah e bëri në periodën e 4-t në të cilën shënoi 21 pikë më shumë se Charlotte duke regjistruar fitoren e 25-të në 31 takime, ecuri kjo që e mban në krye të Konferencës së Perëndimit. Mitchell me 23 pikë ishte më i miri mbi parket për Utahn. U rikthye menjëherë te

fitorja edhe Dallas Mavericksi që mposhti në "American Airlines Center" Memphis Grizzliesin me rezultatin 102-92. Hardaway dhe Luka Doniq, me 50 pikë që koleksionuan të dy së bashku, udhëhoqën Mavericksin drejt suksesit të 5-të në gjashtë ndeshjet e fundit. Vijon rënia e lirë për Houston Rocketsin që pësoi humbjen e 8-të rresht pasi u mposht edhe nga Chicago Bulls brenda në "Toyota Center" në Texas me rezultatin e thellë 100-120. White dhe Zac LaVine me 24 dhe 21 për kokë ishin dy më të mirët mbi parket për Bullsat.

SHKURT

Cikalleshi në formacionin e javës në Turqi

Sokol Cikalleshi shënoi dy gola në ndeshjen e fundit të Konyaspor duke i dhënë fitoren ekipit të tij. Sulmuesi i kombëtares shqiptar përmbysi rezultatin kundër Yeni Malatyaspor. Pas kësaj dopiete sulmuesi është përfshirë edhe në formacionin më të mirë të javës së 26-të në Superligën turke. Cikalleshi është lojtari i vlerësuar me notën më të lartë, 8.6, nga "Sofascore". Sulmuesi këtë sezon ka shënuar vetëm tre gola, por ka zhvilluar ndeshje shumë pozitive.

Mourinho 'harron' Ronaldon: Messi, Pele dhe Maradona janë më të mirë

Trajneri i Tottenham Hotspur, Jose Mourinho nuk e ka futur në mesin e tre lojtarëve më të mirë Cristiano Ronaldon. "Për mua tre lojtarët më të mirë në histori janë Messi, Pele dhe Maradona", ka thënë Mourinho. Duket se raportet e Mourinhos me ish-lojtarin e tij, Ronaldo nuk janë të mira dhe kjo ka ndikuar që ai të mos zgjedh në mesin e tre më të mirëve.

Pirlo, Interit: Juve do të luftojë deri në fund për titull

Trajneri i Juventusit, Andrea Pirlo i ka paralajmëruar rivalët për titull se skuadra e tij do të luftojë deri në fund. "Zonja e Vjetër" ndodhet tetë pikë prapa Interit në renditjen tabelore, ndërsa kanë një ndeshje më pak të zhvilluar. Trajneri vazhdon të besojë në titullin e dhjetë radhazi në kampionatin italian. "Të gjithë ata që ndodhen prapa Interit janë antagonistë, ne jemi një prej tyre dhe do të luftojmë deri në fund", është shprehur Pirlo për "Sky Sport Italia".

Ish-kampioni i Moto GP vdes nga Covidi

Sporti dhe motoçiklizmi është në zi. Fausto Gresini është ndarë nga jeta në moshën 60-vjeçare pasi nuk e fitoi dot betejën me koronavirusin. Ish-motoçiklisti i njohur në karrierën e tij si pilot ka fituar dy tituj kampion në klasin 125 kubik në vitet 1985 dhe 1987, ai krijoi një skuderin në Moto GP me emrin e tij. Pasi krijoi skuderinë e tij, ai në ekip kishte emra të mëdhenj të botës së Moto GP si Marko Simonçeli, Sete Zhibernao, Toni Elias dhe Loris Kapirosi. Italiani u infektua me Covid-19 në muajin dhjetor ku u shtrua në spitalin e Imolës dhe pasi gjendja e tij u përkeqësua ai u transferua tek spitali i Bolonjës nga ku aty ndërroi dhe jetë.

Suarez: Në Barcelonë më thanë se isha shumë i vjetër

Sulmuesi Luis Suarez i ka zbuluar se ishte zhgënjyer kur drejtuesit e Barcelonës i kishin thënë se ishte shumë i vjetër për të luajtur në nivelin më të lartë. Suarez i largua nga Barça dhe iu bashkua Atletico Madridit në shtatorin e kaluar, gjë të cilën ikona dhe kapiteni i katalonasve Lionel Messi e kishte quajtur çmenduri. Sulmuesi uruguaiian ia ka mbyllur gojën ish-klubit të vet, duke e udhëhequr Atletico drejt kreut të La Ligës me golat e tij të njëpasnjëshëm. "Ajo që më pengoi mua në të vërtetë ishte kur më thanë se isha shumë i vjetër dhe se më nuk isha në gjendje të luaja në nivelin e lartë. Kjo nuk më pëlqeu", ka thënë Suarez për "France Football". "Sikur të mos kisha arritur asgjë në një klub si Barça për tri apo katër sezone, do t'i kuptoja. Por, çdo vit në Barça, unë i shënoja më shumë se 20 gola në sezon. Gjithmonë kam pasur statistika të mira, i dyti pas Leo Messit. Rrethanat kanë ndryshuar në Barça dhe klubi kishte nevojë për ndryshim. E pranoj këtë. E vetmja gjë që më pengon është sesi ndodhi. Meritoja respekt", ka shtuar Suarez.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se “Alpha Center Group” SH.P.K. me pronar Arberi Shaqiri, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nr. 811425687 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Alpha Center Group” D.O.O. Arberi Shaqiri, donelo odluku o prestani rada sa nr. 811425687, ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

All clients are to be informed that the “Alpha Center Group” L.L.C. Arberi Shaqiri, has come to the decision to quit its nr. 811425687, the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgage – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement-publication.

**INVITATION TO TENDER**

The Business Support Center Kosovo – BSCK is implementing one of the support measures to previous returnee start-up beneficiaries through additional equipment as a response to the Covid-19 situation. The project is funded by the Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH.

BSCK invites Bidders to submit, free of charge, and without obligation on part of BSCK, a bid on conducting Individual Needs Assessment for 250 selected previously supported beneficiaries.

Send a request for Terms of Reference via email with reference number BSCK/81262908 in the subject line to info@bsckosovo.org.

The responsible BSCK officer will provide you with Terms of Reference (along with the application procedure) within a day.

Additional Requirements: The Bidder shall submit along with the other documents as requested in ToR, the financial offer without VAT.

Bidders are not allowed to contact or discuss any aspect of the tender with BSCK before closing of the tender as it will lead to automatic disqualification.

Request for Terms of Reference must be sent by e-mail to info@bsckosovo.org before 03 March, 2021.

Application deadline is on 05 March, 2021 at 16:00



Daut Dauti është historian, gazetar publicist dhe prozator. Ka kryer studimet në Fakultetin Juridik në Prishtinë, ka magjistruar në West London University në degën e Studimeve Evropiane, kurse ka doktoruar në University of Leeds në shkollën e njohur të historisë të këtij universiteti.

Në fund të viteve '80 ka filluar të merret me gazetari. Shkrimet e para i ka botuar në gazetën e studentëve *Bota e re*, pastaj në revistën *Zëri*. Nga viti 1994 deri më 1999 ka qenë korrespondent i *Zërit* nga Londra. Në vitin 1999 ka filluar të punojë në redaksinë IWPR (Institute for War and Peace Reporting) dhe në këtë vit ka themeluar zyrën e këtij instituti në Prishtinë.

Nga viti 1999 deri më 2002 ka qenë sekretar dhe ndër themeluesit e Shoqatës së Gazetarëve të Kosovës dhe ka shërbyer anëtar i Këshillit Qendror të Zgjedhjeve. Gjatë vitit 2002 në institutin amerikan *Kettering Foundation* ka hulumtuar temën e mediave të pavarura dhe që nga ky vit është anëtar i ekipit hulumtues-studues i këtij instituti. Dauti ka punuar në disa organizata të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare. Ka qenë dhe zëdhënës i Qeverisë së Kosovës në vitin 2005.

Daut Dauti është autor i disa librave dhe punimeve shkencore. Punimet e tij me temë nga fusha e historisë, e gazetarisë dhe e letërsisë janë botuar në mediat shqipe dhe në revista të njohura ndërkombëtare.

Një palë këpucë në Berlin është novela e tij e parë.

4⁹⁹ €

Daut Dauti

NJË PALË KËPUCË NË BERLIN

novelë

Daut Dauti NJË PALË KËPUCË NË BERLIN





REPUBLICA E SHQIPËRISË



Datë 24. 02. 2021

KOMISIONI I PËRBASHKËT SHQIPËRI - KOSOVË PËR MIRATIMIT E TEKSTEVE
MËSIMORE
PËR DIASPORËN



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada – Government

Ministria e Arsimit dhe Shkencës
Ministaro Obrazovanja i Nauke
Ministry of Education and Science



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRI I SHITËTIT
PËR DIASPORËN

THIRRJE PËR APLIKIM NË KONKURSIONIN PËR TEKSTIN MËSIMOR PËR MËSIMIN PLOTËSUES NË DIASPORË DHE MËRGATË, NIVELI I

Komisioni i Përbashkët Shqipëri – Kosovë për Miratimin e Teksteve Mësimore për Diasporën, shpall thirrjen për aplikim në konkursin për tekstin mësimor për mësimin plotësues të gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare në Diasporë dhe në Mërgatë, me titullin “Gjuha shqipe dhe kultura shqiptare” niveli I.

- Teksti mësimor hartohet në përputhje me:
 - Kurrikulën e përbashkët të mëimit plotësues të gjuhës shqipe dhe të kulturës shqiptare në Diasporë dhe Mërgatë”, Tiranë - Prishtinë, miratuar në prill 2018.
 - Standardet e teksteve mësimore për Diasporën, miratuar në shkurt 2021.
- Ftohen të aplikojnë, shtëpitë botuese, që përmbushin kushtet dhe kriteret e përcaktuara në *paketën e dokumenteve mbi procedurat e zhvillimit të konkursit të teksteve mësimore për Diasporën*, miratuar në shkurt 2021 nga Ministri i Arsimit, Sportit dhe Rinisë i Republikës së Shqipërisë, Ministri i Arsimit dhe Shkencës i Republikës së Kosovës, si dhe Ministri i Shtetit për Diasporën i Republikës së Shqipërisë.
- Subjekti aplikues paraqitet brenda kohës së orarit zyrtar të punës, te Komisioni i Përbashkët Shqipëri - Kosovë për Miratimin e Teksteve Mësimore për Diasporën për të dorëzuar dokumentacionin ligjor dhe teknik, si dhe dorëshkrimin e tekstit mësimor përkatësisht:
 - Në datat **26-28 korrik 2021**, në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, në Prishtinë.
 - Në datat **29 – 31 korrik**, në Qendrën e Botimeve për Diasporën, në Tiranë.
- Shpallja e rezultateteve të konkursit, si dhe shpallja e fituesit bëhet në muajin **gusht 2021**.
- Aplikimet e paplota e të pasakta, që nuk janë në përputhje me përcaktimet e paketës së dokumenteve mbi procedurat e zhvillimit të teksteve mësimore për Diasporën apo të kryera përtej afateve të parashikuara, do të refuzohen.
- Për pyetje, lutemi na kontaktoni në adresën (info@qbd.gov.al)
- Për shkarkimin e materialeve të nevojshme për aplikim dhe për hartimin e teksteve mësimore, **klikoni në linkun e mëposhtëm:**

<https://drive.google.com/drive/folders/1fOUmjNY9qIMKhUcQFQ0MVWj3DYyC41u9>

Ministria e Arsimit dhe Shkencës
Adresa: Rruga, Agim Ramadani,
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës
website: www.mashtrks.gov.net/

Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë
Adresa: Rruga e Durrësit, nr 23,
AL 1001 Tiranë, Republika e Shqipërisë
website: www.arsimi.gov.al

Ministri i Shtetit për Diasporën
Bulevardi “Dëshmorët e Kombit, Nr. 1. 1000,
Tiranë, Republika e Shqipërisë,
website: www.diaspora.gov.al



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punës
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook

www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT

SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- ▶ Mustaf Shala shpall të pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu " Emin Duraku " Prizren.
- ▶ Fahreta Elezi shpall të pavlefshme dëftesat e kl VI - IX shfmu " Ekrem Rexha Drini " Prizren.
- ▶ Elvira Redza shpall të pavlefshme dëftesat dhe diplomën shmlt "11 Marsi " Prizren.
- ▶ Esat Musaj shpall të pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu " Dy Dëshmorët " Pirane.
- ▶ Ali Gjakolaj shpall të pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu " Pjeter Budi " Lubizhd e Hasit.
- ▶ Ajdin Qovanaj shpall të pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu " Heronjet e Lumes " Vermic.
- ▶ Bedri Qovanaj shpall të pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu " Heronjet e Lumes " Vermic.
- ▶ Jap banesë me qira afër 60 m2, kati III-Lagja Mati 1 Rr.23-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon . Banesa është e mobiluar komplet, preferoj ta jap banesën me qira për afat të gjatë. Tel: +38344185233.
- ▶ Lëshoj banës me qira në lagjen “Dardania” në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.
- ▶ Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.
- ▶ Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.
- ▶ Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.
- ▶ Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.
- ▶ Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Urgjentisht kërkoh një banesë me qira në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188
- ▶ Lëshoj lokalit më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

